

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Mbrojtësi i Specializuar i Hashim Thaçit

Data: 30 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Rishikim, Zgjatje të Afatit dhe Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësi i Hashim Thaçit
Dejvid Huper

Mbrojtësi i Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësi i Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtësja e Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

I. HYRJE

1. Mbrojtja e z. Hashim Thaçi ("Mbrojtja") kërkon rishikimin e Vendimit për Ndryshimin e Afatit¹, në përputhje me rregullën 79 të Rregullores së Procedurës dhe Provave ("RRPP"), si dhe zgjatjen e afatit e shtimin e numrit të lejuar të fjalëve për të paraqitur përgjigjen e vet ndaj Kërkesës së Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") për Masa Mbrojtëse² dhe Parashtrimin Plotësues.³

II. HISTORIKU PROCEDURAL

2. Më 19 nëntor 2020, ZPS-ja paraqiti, me klasifikimin rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, Kërkesë për Masa Mbrojtëse bashkë me shtojcat shoqëruese të saj.⁴ Një version i redaktuar konfidencial i kërkesës u protokollua më 24 nëntor 2020.⁵
3. Më 26 nëntor 2020, ZPS-ja paraqiti një version të redaktuar konfidencial të Parashtrimin të saj Plotësues të Kërkesës për Masa Mbrojtëse, me shtojcat shoqëruese.
4. Në përputhje me rregullat 9 dhe 76 të RPP-së, Mbrojtja kishte të drejtë t'i përgjigjej Kërkesës dhe Parashtrimin Plotësues brenda 10 ditësh nga marrja e njoftimit për to.
5. Më 27 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin për Ndryshimin e Afatit, përmes të cilit ai urdhëroi Mbrojtjen të paraqiste një përgjigje

¹ KSC-BC-2020-06/F00104, Vendim për Ndryshimin e Afatit, 27 nëntor 2020 ("Vendimi për Ndryshimin e Afatit").

² KSC-BC-2020-06/F00102/CONF/RED, Version i redaktuar konfidencial i 'Kërkesës për Masa Mbrojtëse', 19 nëntor 2020 me Shtojcën konfidenciale 13, 24 nëntor 2020 ("Kërkesa").

³ Version i redaktuar konfidencial i Parashtrimin Plotësues të Kërkesës për Masa Mbrojtëse, me shtojcat e redaktuara konfidenciale 1 dhe 2, KSC-BC-2020-06/F00102, 26 nëntor 2020 ("Parashtrimi Plotësues").

⁴ KSC-BC-2020-06, F00094, Prokurori i Specializuar, Kërkesë për Masa Mbrojtëse, 19 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-13, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁵ *Shih*, Kërkesa.

përmbledhëse ndaj Kërkesës dhe Parashtrimit Plotësues deri të **premtën, më 4 dhjetor 2020, në orën 12:00.**

6. Më 27 nëntor 2020, mbrojtësi i Rexhep Selimit ("Mbrojtja e Selimit") kërkoi rishikimin e Vendimit për Ndryshimin e Afatit, si dhe një ndryshim të numrit të lejuar të fjalëve dhe afatit për paraqitjen e përgjigjes së tij ndaj Kërkesës dhe Parashtrimit Plotësues.⁶

III. PARASHTRIMET

7. Masat mbrojtëse të kërkuara nga ZPS-ja (dhe provat mbështetëse në të cilat është bazuar) përmbajnë mbi 100 faqe parashtrime si dhe një numër prej më shumë se 32.000 fjalësh. Rrjedhimisht, këto parashtrime janë më shumë se pesë herë më të gjata se numri normal i lejuar prej 6.000 fjalësh për një mocion. Pavarësisht nga kjo, Mbrojtja duhet të paraqesë përgjigjen e saj ndaj Kërkesës dhe Parashtrimit Plotësues brenda afatit të zakonshëm 10-ditor.
8. Madhësia dhe kompleksiteti i parashtrimeve të ZPS-së lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve nuk janë befasese. Ruajtja e ekuilibrit të saktë ndërmjet trajtimit të frikës objektive që shprehin dëshmitarët dhe domosdoshmërisë për një gjykim publik, është diçka e vështirë. Në gjykatat e tjera ndërkombëtare kjo është luhatur midis miratimit të kërkesave për masa mbrojtëse ndaj gjithë dëshmitarëve të renditur në lista nga njëra anë dhe zbatimit të një standardi rigoroz për vlerësimin e frikës të tyre objektive nga ana tjetër.

⁶ KSC-BC-2020-06/F00105, Kërkesë e Mbrojtjes për Rishikimin e Vendimit për Ndryshimin e Afatit dhe Kërkesë për Zgjatjen e Afatit e Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 27 nëntor 2020 ("Kërkesë për Rishikim e Selimit").

9. Mënyra se si do të garantohet ky ekuilibër nga kjo Dhomë, do të ndikojë mbi shumë aspekte të këtij procesi gjyqësor, duke përfshirë edhe kufizimet që duhet të vendosen ndaj hetimeve të Mbrojtjes. Duke qenë se kjo çështje gjyqësore është edhe shqyrtimi i parë i interesave të rëndësishme dhe konkurrenente në këtë rast, Mbrojtjes duhet t'i jepet mundësia të paraqesë argumente të bazuara në prova dhe të matura lidhur me aspektin nëse qasja e Prokurorisë për mbrojtjen e dëshmitarëve është me të vërtetë e saktë. Afati i tanishëm nuk e lejon këtë.
10. Në veçanti, duke kërkuar miratim për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve për kërkesën, Prokuroria përmendi “kompleksitetin e provave të kësaj çështjeje, vëllimin e madh të materialeve që trajtohen dhe parashtrimet e hollësishme që duhet të paraqiten”.⁷ Mbrojtjes do t'i bëhej një padrejtësi nëse për të njëjtët elemente të kësaj çështjeje gjyqësore asaj do t'i hiqej mundësia për të pasur kohë të mjaftueshme për të shqyrtuar dhe dhënë përgjigje në mënyrën e duhur ndaj parashtrimeve dhe provave të gjera të ZPS-së.
11. Rrjedhimisht, është i përligjur rishikimi i Vendimit për Ndryshimin e Afatit në përputhje me rregullën 79 të RRPP-së, në mënyrë që afati i tanishëm të zëvendësohet me atë që propozohet në Kërkesën për Rishikim të Mbrojtjes së z. Selimi, e që është data **14 dhjetor 2020**. Ekzistojnë arsye të vlefshme për këtë ndryshim, të cilat i trajtuam më lart.
12. Sa i përket afatit 30-ditor për dorëzimin e materialit mbështetës të Aktakuzës, sipas rregullës 102(1)(a), ky afat nuk duhet të lejohet të funksionojë në dëm të të akuzuarit, ose të sabotojë paraqitjen e duhur të aspekteve të rëndësishme të kësaj çështjeje. Rrjedhimisht, Mbrojtja parashtron se në përputhje me rregullën 9(5)(a) ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit të përcaktuar në rregullën

⁷ Kërkesa, para. 4.

102(1)(a) për nxjerrjen e materialit mbështetës deri në kohën kur të jetë bërë paraqitja dhe shqyrtimi i plotë i Kërkesës dhe Parashtrimit Plotësues dhe të jenë zbatuar redaktimet e duhura. As marrja e një vendimi të menjëhershëm mbi këtë kërkesë nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, në përputhje me rregullën 9(6), nuk do t'i shkaktonte ndonjë padrejtësi ZPS-së ose mbrojtësit të viktimave.

13. Sa i përket numrit të lejuar të fjalëve për përgjigjen e saj përmbledhëse, Mbrojtja parashtron se arsyet në të cilat u mbështet Prokuroria kur kërkoi në mënyrë prapavepruese shtimin e numrit të lejuar të fjalëve për Kërkesën e saj,⁸ ofrojnë arsye të vlefshme, sipas nenit 36(1) të Udhëzuesit të Punës⁹, për një shtim ekuivalent të numrit të lejuar të fjalëve për palët që përgjigjen.

IV. PËRFUNDIM

14. Për arsyet e lartpërmendura, Mbrojtja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

TË RISHIKOJË Vendimin për Ndryshimin e Afatit dhe të autorizojë Mbrojtjen që të paraqesë një përgjigje përmbledhëse ndaj Kërkesës dhe Parashtrimit Plotësues deri më **14 dhjetor 2020, në orën 12:00;**

TË AUTORIZOJË një ndryshim ekuivalent të numrit të lejuar të fjalëve ndërmjet Prokurorisë dhe Mbrojtjes; dhe

TË ZGJASË afatin për dorëzimin e materialit mbështetës të Aktakuzës nga ZPS-ja, sipas rregullës 102(1)(a), në pritje të vendimit lidhur me Kërkesën dhe Parashtrimit Plotësues dhe zbatimit të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

⁸ Kërkesa, para. 295.

⁹KSC-BD-15, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019.

[Numri i fjalëve (në origjinal): 1049]

Paraqiti me respekt,

_____ nënshkrimi _____

Dejvid Huper

Mbrojtës i Specializuar i Hashim Thaçit

E hënë, 30 nëntor 2020

Në Londër, Britani e Madhe